

ΜΕΝΔΟΥΔΡΙΑΙ ΤΟΙΕ

Kremtimi i dyqindvjetorit të revolucionit grek përkon me kryengritjet dhe revoltat bashkëkohore mbarëbotërore, kundrejt trashëgimisë kolonializuese mbizotëruese të racës së «bardhë», të nacionalizmit dhe të kapitalizmit racor.

Sot, statujat dhe monumentet që nderojnë supremacistët «e bardhë» dhe tregtarët e skllervëve zhvlerësohen në mënyrë spektakolare në të gjithë botën, ndërsa kërkesat e lashta për dëmshpërblime dhe shfuqizimin e policisë rishikohen fuqimisht. Aktivistët e «Black Lives Matter», protestuesit autoktonë dhe lëvizjet shoqërore nga Palestina deri në Amerikën e Jugut nuk shfaqen thjesht për të vënë në dyshim imperializmin britanik apo trashëgiminë raciste amerikane, por kanë si synim të shkatërrojnë totalisht grehinën perëndimore të kapitalizmit racor, e cila është ndërtuar mbi kurrizin e të ashtuquajturave «të mjerët e dheut». Duke marrë shkas nga përpjekje të tilla, iniciativa e dekolonializmit të - Hellas, sjell pikë së pari si nevojë urgjente një rishqyrtim të vendit që zë Greqia e sotme - moderne, në lidhje me gjeografitë dhe gjenealogjitë e kolonializimit evropian.

Shteti - komb grek, shpesh përshkruhet si «vatra e civilizimit evropian» dhe si «djepi i demokracisë», kurse revolucioni grek shikohet me krenari si revolucioni i parë etnik në Evropë. Evropa dhe Perëndimi nënkuptohen si sinonime të progresit, përparimit, racionalizmit, drejtësisë si dhe të lirisë. Por për shumë dhjetëvjeçarë, përpjekjet anticolonializuese si dhe teoria e dekolonializmit dhe post - kolonializmit, kanë

nxjerrë në pah shfrytëzimin kapitalist, ndarjet etnike, dhunën genocidale mbizotërimin e racës «së bardhë», sistemin patriarkal, antisemitizmin si dhe islamofobinë, si elemente që përbëjnë bazën materiale - ideologjike të Evropës.

Nën këtë prizëm, revolucioni grek nuk shënon vetëm thyerjen - shkëputjen me Perandorinë Otomane, por edhe fillimin e një procesi të gjatë të përvetësimit të rrëfimeve dhe të praktikave tashmë në shërbim të ashtëquajturit «mision civilizues». Themelimi dhe forcimi i shtetit të ri, solli si rezultat prurjen e disa lëvizjeve dhe akteve të shumëllojshme sikurse: spastrime etnike, krijimi dhe mbikqyrja policore e minoriteteve, mohim të identitetit dhe homogjenizimin e dhunshëm, të cilat shpesh bazoheshin në patologjizimin e një situatë ish-ekzistuese në nivel fetar, lingvistik, diversitet kulturor në një terren bashkëekzistues gjatë periudhës Otomane.

Fillimisht kjo dhunë e papërshkrueshme, e cila goditi rëndë popullsi, që nuk harmonizoheshin me spastrimin fetar, helen - ortodoks shtet - komb, por më vonë u shtri edhe në subjekte, të konsideruara të rrezikshme apo të mangëta në nivele të tjera sikurse, regjistri gjuhësor, formimi kulturor, bindjet politike, identiteti gjinor si dhe orientimi seksual.

dëcolonize hellas

Nisma e dekolonializmit të - Hellas do të paraqesë në plan të parë marrëdhëniet ambivalente dhe reciproke midis shtetit komb grek dhe gjenealogjive koloniale të Evropës. Ndërsa Greqia është analizuar në të kaluarën si një «skemë koloniale», «kripto - koloni» dhe, kohët e fundit, si një «koloni me borxhe», është urgjente të rishikohet në plan të parë roli i «Hellas» në bashkë - konstituimin e projektit kolonial Evropian.

Me termin «Hellas», nënkuptohet një bashkësi e ideologjive (helenizmave të ndryshëm) dhe institucioneve, materialeve dhe imazheve, politikave dhe teknologjive, trupave dhe popullatave, identiteteve dhe ndikimeve, brenda dhe përtej afateve kohore dhe kufijve të shtetit komb - grek (Ellada).

«Hellas» si një ndërtim i Perëndimit, rezultat i një imazhi të idealizuar të Greqisë Antike ka qenë thelbësore për formësimin e modernitetit Evropian - si dhe për legjitimimin e ekzistencës së një «Greqie Moderne». Vlerat, estetika dhe hierarkitë evolucionare të klasicizmit janë përdorur për të justifikuar epërsinë perëndimore dhe racionalizimin e pushtimit

dhe skllavërimit evropian në të gjithë botën. Kuptimi i «Hellas», sidoqoftë, përfshin gjithashtu mbështetjen e krishterë dhe fetare të traditave gjoja «sekulare» perëndimore dhe përdorimin diakronik të Greqisë si një zonë - digë, kufiri kulturor dhe mbrojtës midis Krishtëritit dhe Islamit, Lindjes dhe Perëndimit, kapitalizmit dhe komunizmit, «civilizimit» dhe «barbarizmit».

Me termin dekolonializim i «Hellas» do të thotë të ekspozosh gjenealogjitë koloniale që ushqejnë orientalizmin, ballkanizmin, ksenofobinë, racizmin, homofobinë dhe seksizmin e artikulluar në emër të saj. Duke ndjekur riformimin aktiv të «Hellas» përmes formave emergjente, emancipuese dhe krijuese të përkatësisë, ne gjithashtu shpresojmë të frymëzojmë aktivizimin dhe dokumentimin e përvojave dhe praktikave, kujtimeve dhe lëvizjeve, gjenealogjive dhe marrëdhënieve shpesh të marginalizuara, banalizuara dhe të bëra të padisponueshme. në kornizat mbizotëruese përkujtimore dhe interpretuese, duke hapur kështu rrugë për një të ardhme më të përshtatshme bshkëekzistuese dhe gjithëpërfshirëse.

С Ы Н И М Э Т Т О Н А

Nisma për dekolonializmin e «Hellas», aspirojnë të jetë një platformë nomade ku akademik, studiues, artist, intelektual publik e aktivistë të shoqërisë civile - që kontribuojnë në lëvizjen globale të dekolonializmit - angazhohen për zhvillim të debateve të qëndrueshme në lidhje me efektet afatgjata të kolonizimit, racizmit dhe ksenofobisë në Greqi dhe në botë. Këto aspirata do të zhvillohen në dialog me lëvizjet dekolonializuese në Ballkan, Lindjen e Mesme dhe Jugun Global si dhe në lidhje me lëvizjet globale për të drejtat autoktone dhe të refugjatëve.

- ▶ Përmes kërkimit kolektiv, grupeve të punës, aktiviteteve publike, botimeve dhe mësimdhënies, kjo nismë synon të hapë një hapësirë publike reflektuese për shkëmbim dhe eksperimentim që mund të stimulojë hulumtime të rëndësishme që janë bërë tashmë në këto tema të cilat tejkalojnë ndarjet insitucionale dhe disiplinën akademike.
- ▶ Synimi tjetër i kësaj nisme është, të krijoj horizonte të reja kërkimore, metoda të reja dhe të organizojë aktivitete rreth tri grupeve tematike që përfaqësojnë në këndvështrimin tonë fushat më të rëndësishme të punës, mendimit dhe mobilizimit kolektiv: Kombi dhe Raca, Kujtesa dhe Monumentet, Kozmopolitizmat & Kozmopolitika.
- ▶ Ne synojmë të lidhim kremtimin e dyqindvjetorit të revolucionit grek me temën e diskutimit aktual global mbi kolonializmin, orientalizmin/ballkanizmin, eurocentrizmin, epërsinë e «të bardhëve», patriarkatin, kapitalizmin racor, qarkullimin ndërkombëtar të kapitalit dhe qeverisjen globale. Çështje të tilla do të diskutohen në një simpozium ndërkombëtar me titull *Dekolonializmi i «Hellas»*. E kaluara hegjemone perandorake, *Kontestimi i së tashmes*, E ardhmja emancipuese 1821-2021, që është planifikuar për në Tetor 2021.